



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR NGRITJEN E BORDIT TË MONITORIMIT TË MEDIAS PËR MONITORIMIN E
FUSHATËS ZGJEDHORE NË RADION DHE TELEVISIONIN PUBLIK DHE ATO
PRIVATE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 28.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Ngritja e Bordit të Monitorimit të Medias për monitorimin e fushatës zgjedhore në radion dhe televisionin publik dhe ato private.

BAZË LIGJORE: Neni 23 pika 1, germa a, neni 85 pika 1, neni 85/1 i ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur, si dhe dëgjoji diskutimet e të pranishmëve,

VËREN

Neni 85, pika 1, i ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë," i ndryshuar, parashikon ngritjen nga KQZ, të Bordit të Monitorimit të Medias, 40 ditë përpara fillimit të periudhës zgjedhore. Ky Bord ka për detyrë monitorimin e zbatimit të dispozitave të këtij Kodi për fushatën zgjedhore në radion dhe televisionin publik dhe ato private.

Neni 85/1 i Kodit Zgjedhor parashikon procedurën që ndiqet për ngritjen e BMM. Në mbështetje të nenit 85/1, KQZ, me shkresën nr. 21 prot., datë 09.01.2019, i kërkoi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë listën e organizatave jofitimprurëse kombëtare që operojnë në fushën e medias. Gjykata e Rrethit Tiranë me shkresën nr. 21/1 prot., datë 23.01.2019 dërgoi listën këtyre e organizatave që operojnë në fushën e medias. KQZ, në përputhje me afatin e përcaktuar në nenin 85/1, germa b, u dërgoi organizatave të



Nr. 694 i Vendimit Data 28.05.2019 e vendimit Ora 12:00

Për ngritjen e Bordit të Monitorimit të Medias për monitorimin e fushatës zgjedhore në radion dhe televisionin publik dhe ato private.

sipërcituara kërkesën për të propozuar secila jo më pak se tre kandidatura për anëtar të BMM.

Bordi i Monitorimit të Medias përbëhet nga 7 anëtarë. Secili nga anëtarët e KQZ-së cakton një anëtar nga propozimet e bëra nga organizatat jofitimprurëse për BMM.

5 Anëtarët e KQZ-së pas konsultimit dhe verifikimit të propozimeve të paraqitura vendosën si më poshtë:

Z. Klement Zguri i paraqet KQZ-se për emërimin si anëtar të Bordit të Monitorimit të Medias z. Artan Cena, propozuar nga "QENDRA PËR INFORMIM TË HAPUR" me shkresën nr.4898 prot., datë 27.05.2019.

Z. Denar Biba i paraqet KQZ-se për emërimin si anëtar të Bordit të Monitorimit të Medias z. Dardan Malaj, propozuar nga "QENDRA PËR INFORMIM TË HAPUR" me shkresën nr.4898/4 prot., datë 27.05.2019.

Z. Bledar Skënderi i paraqet KQZ-së për emërimin si anëtar të Bordit të Monitorimit të Medias z. Bledar Lumani, propozuar nga "QENDRA PËR INFORMIM TË HAPUR" me shkresën nr.4898/1 prot., datë 27.05.2019.

Znj. Edlira Jorgaqi, i paraqet KQZ-së për emërimin si anëtar të Bordit të Monitorimit të Medias z. Ylli Pata, propozuar nga "QENDRA PËR INFORMIM TË HAPUR" me shkresën nr.4898/2 prot., datë 27.05.2019.

Znj. Rezarta Bitri i paraqet KQZ-së për emërimin si anëtar të Bordit të Monitorimit të Medias, z. Maklen Misha, propozuar nga "QENDRA PËR INFORMIM TË HAPUR" me shkresën nr.4898/3 prot., datë 27.05.2019.

KQZ, nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se personat e paraqitur për emërim si anëtar të BMM plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 85/1, germa c, të Kodit Zgjedhor të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23 pika 1, germa a, nenin 85 pika 1, neni 85/1 i ligjit nr.10019, datë 29.12. 2009 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 4 pika 1 dhe neni 5 i Rregullores të Bordit të Monitorimit të Medias, miratuar me vendimin e KQZ-së nr.155, datë 7.05.2009, Për miratimin e rregullores "Për përbërjen, mënyrën e ngritjes dhe të funksionimit si dhe procedurat që ndjek Boardi i Monitorimit të Medias" i ndryshuar,



Nr. 694 i Vendimit Data 28.05.2019 e vendimit Ora 12:00

Për ngritjen e Bordit të Monitorimit të Medias për monitorimin e fushatës zgjedhore në radion dhe televizionin publik dhe ato private.

V E N D O S I:

1. Ngritjen e Bordit të Monitorimit të Medias, për monitorimin e fushatës zgjedhore në radion dhe televizionin publik e ato private, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.
2. Miratimin e përbërjes së Bordit të Monitorimit të Medias, si më poshtë:
 1. Z. Artan Cena
 2. Z. Bledar Lumani
 3. Z. Dardan Malaj
 4. Z. Ylli Pata
 5. Z. Maklen Misha
3. Mbledhja e parë e Bordit të Monitorimit të Medias do të zhvillohet në datë 29.05.2019, në ambientet e selisë së AMA-së.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve, nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 694 i Vendimit Data 28.05.2019 e vendimit Ora 12:00

Për ngritjen e Bordit të Monitorimit të Medias për monitorimin e fushatës zgjedhore në radion dhe televizionin publik dhe ato private.